



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

**Bordi**

**VENDIM**

**Nr. 251, Datë 11.12.2018**

**MBI**

**MIRATIMIN E DISA AMENDIMEVE PËR PROPOZIMIN E TË GJITHË OST-VE  
MBI “UDHËZUESIN PËR KËRKESAT ORGANIZATIVE, ROLET DHE  
PËRGJEGJËSITË NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE” (KORP)**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike“ i ndryshuar, nenit 40 pika 6 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit European BE 2017/1485, “Mbi Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (SO GL)”, nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike, për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP),

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 159, datë 09.07.2018, ka miratuar “Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).
- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sha,) me shkresën e protokolluar në ERE me Nr. 674 Prot, datë 22.10.2018, ka përcjellë për miratim, amendimet për propozimin e të gjithë OST-ve mbi këtë Udhëzues.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 233, datë 02.11.2018, filloi procedurën për miratimin e amendimeve për propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave (KORP)
- ERE me shkresën Nr. 55/67 Prot, datë 02.11.2018, ka publikuar në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure dhe me shkresën Nr. 674/1 Prot, datë 06.11.2018, ka dërguar këtë vendim pranë palëve të interesit.
- Këto amendime janë propozuar nga Autoritetet Rregullatore të vendeve anëtare të BE sipas marrëveshjes së arritur në Forumin e Rregullatorëve të Energjisë më 23 Korrik 2018. Në përputhje me këtë marrëveshje, amendimet i janë përcjellë dhe njëherë ENTSO-E për konsultim dhe aprovim nga antarët e saj.
- Nga ENTSO-E, në cilësinë e hartuesit të KORP, në datën 9 Tetor 2018, u krye votimi në lidhje me këto amendime, i cili rezultoi në favor të miratimit të tyre.

- Amendimet mbi “Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë në Lidhje me Shkëmbimin e të Dhënave (KORP), janë bashkëlidhur këtij vendimi dhe konsistojnë kryesisht në një sistemim sintaksor dhe leksik më të mirë të strukturës së këtij Udhëzuesi, me qëllim kuptimin më të mirë nga ana e palëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të miratojë amendimet për propozimin e të gjithë OST-ve pjestare të ENTSO-E, mbi “Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave (KORP). (Bashkëlidhur Udhëzuesi i amenduar).
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**